

## **Pyetje të shpeshta lidhur me përditësimin e kushteve të përgjithshme të kontratës dhe të perfshirjes së indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) në keto kushte.**

### **Cfarë ndryshimesh janë kryer në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës?**

Ne Kushtet e Përgjithshme të Kontratës të cilat hyne në fuqi në datë 1 Mars 2024, përveç perfshirjes së indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), janë shtuar/ përditesur disa klauzola që janë në favor të pajtimtareve mobile dhe fikse si:

1. Për shërbimet fikse është përditësuar klauzola e kohëzgjatjes së kontratës më shumë se 24 muaj vetëm kur kjo vjen si kërkesë e pajtimtarit ose pranohet me dëshirën e lirë të të dy palëve nënshkruese.
2. Kontrata e pajtimtarit kthehet në kontratë të hapur nëse pajtimtari nuk kërkon përfundimin e saj 30 ditë përpara përfundimit të vlefshmerisë së saj.
3. Rregullime në lidhje me aneksin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe përcaktimi i një aneksi të veçantë për tarifën dhe shërbimet standarde për shërbimim celular.
4. Shtimi i disa dispozitave për shërbimet fikse në lidhje me Portabilitetin e Numrave (njëlloj si në kontratën për abonentët mobile)

### **Sa është norma/ përqindja e rritjes që pritet të aplikohet?**

Indeksi mesatar vjetor i çmimeve të konsumit (IÇK) të publikuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT) për vitin 2023 është 4.8%, norma e cila aplikohet mbi tarifën standarde të planit tarifor.

### **Kur do aplikohet norma IÇK-së?**

Çdo abonent do njoftohet me anë të një SMS-je informuese, 30 ditë përpara aplikimit të saj.

### **Si mund të veprojmë nëse nuk jam dakord me përfshirjen në kushtet dhe termat e përgjithshme të së drejtës së operatorit për aplikimin e normës IÇK?**

Nga momenti i marrjes së SMS informuese për përditësimin e kushteve të përgjithshme të kontratës, ju mund të shprehni me shkrim për tërheqjen pa penalitet nga kontrata, brenda 30 ditëve nga marrja e kësaj SMS.